



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 8/3 prot.

Tiranë, më 11.022026

VENDIM  
Nr. 13, datë 11.02.2026

PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 38, DATË 13.10.2025

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 38, datë 13.10.2025, të Komisionerit, "Mbi përfundimin e procesit të inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil në institucionin e Bashkisë Lushnje dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë",

**KONSTATOVA SE:**

Me Urdhrin nr. 59 (642 prot.,) datë 26.6.2025 "Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, në institucionin e Bashkisë Lushnje", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në ushtrim të kompetencave të tij ligjore mbikëqyrëse, ka filluar kryesisht verifikimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, lidhur me procedurën e hartimit dhe miratimit të akteve të përshkrimit të punës për pozicionet pjesë e shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Lushnje.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 38, datë 13.10.2025, të Komisionerit, "Mbi përfundimin e procesit të inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil në institucionin e bashkisë lushnje dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë", nëpërmjet të cilit, për shkak të konstatimit të mangësive në zbatimin e kuadrit ligjor përkatës, institucioni është

paralajmëruar dhe janë vendosur detyra konkrete për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Brenda afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, me shkresën nr. 9051/1 prot., datë 2.12.2025, "*Kthim përgjigje shkresës suaj me nr. 642/2 prot., datë 13.10.2025*", ka informuar në lidhje me procesin e rivlerësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Lushnje.

Në kushtet kur në përmbajtjen e shkresës së sipërcituar nuk ishte dërguar informacion dhe dokumentacion provues i plotë në lidhje me detyrat e lëna në dispozitivin e vendimit paralajmëruar, Komisioneri, me shkresën nr. 8 prot., datë 5.1.2026, "*Kërkohej informacion mbi zbatimin e Vendimit nr. 38, datë 13.10.2025, të Komisionerit, për rregullimin e ligjshmërisë*", ka kërkuar nga Bashkia Lushnje informacion në lidhje me ecurinë e veprimeve të ndërmarra në përmbushje të detyrimeve të vendosura në dispozitivin e vendimit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Lushnje me shkresën nr. 61/1 prot., datë 7.1.2026, "*Kthim përgjigje shkresës suaj me nr. 8 prot., datë 5.1.2026*", ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin që materializon veprimet administrative në zbatim të vendimit, objekt i mbikëqyrjes në vazhdim.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 38, datë 13.10.2025, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, vlerësoj se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të vendimit paralajmëruar, Komisioneri ka vendosur detyrime të qarta procedurale për njësinë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, me qëllim përfundimin e procesit të hartimit dhe miratimit të akteve të përshkrimit të punës, si element thelbësor i administrimit të shërbimit civil dhe garantimit të sigurisë juridike të marrëdhënies së punës.

Konkretisht, është kërkuar që formularët e përshkrimit të punës të nënshkruhen nga eprori direkt dhe të njihen nga nëpunësi civil i emëruar në pozicionin përkatës, si dhe të plotësohen kriteret e posaçme të pozicionit, përfshirë fushën përkatëse të arsimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Po ashtu, është kërkuar pasqyrimi i këtyre të dhënave në Regjistrin Qendror të Personelit dhe përfshirja e akteve përkatëse në dosjen individuale të personelit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në kuadër të mbikëqyrjes në vazhdim konstatoj se detyrimet e mësipërme janë përmbushur në mënyrë të plotë dhe efektive. Aktet e përshkrimit të punës janë hartuar, miratuar dhe nënshkruar sipas procedurave të përcaktuara, janë reflektuar në Regjistrin Qendror të Personelit dhe janë përfshirë në dosjen e personelit për çdo nëpunës civil, duke sjellë si pasojë juridike përfundimin e procesit të rregullimit të ligjshmërisë për këto pika të vendimit paralajmëruar.

Në lidhje me **pikën 6** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar rivlerësimin e pozicioneve të punës, si një proces me natyrë juridiko-administrative, që synon përshtatjen e përshkrimit të pozicionit me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse dhe sigurimin e koherencës ndërmjet funksioneve, përgjegjësi dhe kërkesave të pozicionit.

Konkretisht, rivlerësimi është kërkuar për pozicionet e mëposhtme:

- :: Specialist i Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
- :: Specialist për Planifikim dhe Përballimin e Emergjencave Civile dhe Krizave, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike;
- :: Specialist i Integritit European dhe Ndihmën e Huaj, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun;
- :: Specialist i Shkrimit të Projekteve, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun.

Nga verifikimi i dokumentacionit vërej se institucioni i mbikëqyrur ka kryer procesin e rivlerësimit përmes Komisionit të Vlerësimit të Pozicioneve, duke hartuar tabelën përkatëse të rivlerësimit dhe duke reflektuar përfundimet e këtij procesi në formularët e përshkrimit të punës. Këto veprime dëshmojnë përmbushjen e detyrimit të vendosur dhe rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë edhe për këtë pikë të vendimit paralajmërues.

Për sa u parashtrua më sipër, çmoj se Bashkia Lushnje ka përmbushur në mënyrë të plotë detyrimet e vendosura në vendimin paralajmërues nr. 38, datë 13.10.2025, të Komisionerit, duke eliminuar shkeljet e konstatuara dhe duke rivendosur gjendjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil për çështjet objekt i inspektimit të thelluar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 38, datë 13.10.2025, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil në institucionin e Bashkisë Lushnje dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Lushnje duke zbatuar detyrat e lëna në dispozitivin e Vendimit nr. 38, datë 13.10.2025.

3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Lushnje.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Konceptoi: B. Zyli

Pranoi: E. Hebibasi

Miratoi: A. Basha